Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government
Ministria e Digjitalizimit dhe Administratës Publike - Ministarstvo digitalizacije i javne uprave - Ministry of Digitalization and Public Administration

Raport mbi zbatimin e Strategjisë për Reformën e Administratës Publike SRAP 2022-2027: **Raporti gjashtë-mujor, Janar - Qershor 2026**

Gusht, 2026

Përmbledhje

Lista e shkurtesave 3

1. Hyrje 4

2. Përmbledhje Ekzekutive 4

3. Progresi i përgjithshëm 6

4. Problemet dhe rreziqet 16

5. Hapat e ardhshëm 17

Shtojca: Progresi kundrejt veprimeve – zbatimi i aktiviteteve janar-qershor 2026 19

Lista e shkurtesave

AIP	Agjencia për Informim dhe Privatësi
AShI	Agjencia e Shoqërisë së Informacionit
DRAP	Departamenti për Reformën e Administratës Publike
DMZP	Departamenti për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë
SIMBNj	Sistemi Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore
IKAP	Instituti i Kosovës për Administratë Publike
KPMSHC	Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil
LPPA	Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative
LZP	Ligji për Zyrtarët Publik
KMRAP	Këshilli Ministror për Reformën e Administratës Publike
MDAP	Ministria e Digjitalizimit dhe Administratës Publike
PKZMSA	Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit
ZQM/ZKM	Zyra për Qeverisje të Mirë e Zyrës së Kryeministrit
ZKM	Zyra e Kryeministrit
SRAP	Strategjia për Reformën e Administratës Publike
MBS	Mbështetja Buxhetore e Sektorit
GVRAP	Grupi i Veçantë për Reformën e Administratës Publike
ZPS/ZKM	Zyra për Planifikim Strategjik e Zyrës së Kryeministrit
KRS-RAP	Kontratë e Reformës Sektoriale për Reformën e Administratës Publike

1. Hyrje

Ky raport shqyrton dhe analizon procesin, rezultatet dhe sfidat në kuadrin e zbatimit të Strategjisë për Reformën e Administratës Publike (SRAP 2022-2027) dhe Planin e saj të ri-shikuar të Veprimit (PV 2025-2027), për periudhën kohore Janar - Qershor 2026. Raporti është përgatitur në atë mënyrë që përmban dy ndarje të aspektit të monitorimit dhe raportimit: 1) aktivitet që periudhën e zbatimit e kanë TM1-TM2 2026, dhe që janë pjesë e kalkulimit të zbatimit; dhe 2) aktivitetet që mbajnë statusin e zbatimit "në vazhdimësi", dhe apo që përfundojnë së zbatuari në periudhën TM4 2026. Kjo ndarje është bërë me qëllim që t'i mbajë vendimmarrësit më mirë të informuar rreth procesit, dhe në anën tjetër t'i informoj institucionet zbatuese për progresin kundrejt planifikimit, t'i mbajë më të përgjegjshme në zbatim, të rrisë proaktivitetin dhe marrjen e veprimeve pasuese deri në Raportin Vjetor, me qëllimin e vetëm, rritjen e nivelit të zbatimit dhe përmbushjen e Objektivave Strategjikë të SRAP.

Raporti është përgatitur nga Departamenti për Reformën e Administratës Publike të Ministrisë së Digjitalizimit dhe Administratës Publike (DRAP/MDAP). Raporti bazohet në të dhënat e raportuara në DRAP/MDAP nga njësitë përgjegjëse për zbatim. Procesi i përgatitjes së raportit bazuar edhe në udhëzuesin për monitorim dhe raportim përbëhet nga tre faza: njoftimi dhe mbledhja e të dhënave, analiza e të dhënave, dhe hartimi i raportit. Përgatitjes së raportit i ka paraprirë procesi i monitorimit të institucioneve zbatues, në komunikim të vazhdueshem përmes email-eve njoftues dhe ri-kujtues me institucionet përkatëse, dhe takimeve individuale me secilën njësi duke i nxitur ato të raportojnë për zbatimin e aktiviteteve

Gjatë vitit 2026, Këshilli i Ministrave për RAP (KMRAP) ka mbajtur një takim, më 28 maj 2026, dhe përfundimet kryesore – përveç miratimit të raporteve vjetore – kanë përfshirë forcimin e bashkëpunimit dhe koordinimit institucional, veçanërisht me Departamentin për Reformën e Administratës Publike dhe Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë.

2. Përmbledhje Ekzekutive

Raporti i zbatimit të (PV) 2025-2027 i gjashtë (6) mujorit të parë për vitin 2026 synon të përmbledhë arritjet, të bëjë përshkrimin e gjendjes dhe përmbushjen e masave reformuese të parapara për këtë periudhë kohore, si dhe të identifikojë sfidat, vështirësitë, dhe rreziqet që quan në (mos)zbatimin e këtyre masave të planifikuara, njëherit të informojë vendimmarrësit për nivelin e zbatimit të këtyre masave dhe veprimeve që duhen ndërmarrë për zbatimin e tyre në periudhën e mbetur (qershor-dhjetor 2026).

Plani i Veprimit 2025-2027 për zbatimin e Strategjisë së Reformës së Administratës Publike (SRAP) 2022-2027 përfshinë gjithsej dyzet e tre (43) veprime për zbatim në gjashtëmujorin e parë të vitit 2026. Nga këto: tetëmbëdhjetë (18) veprime (apo 41.9%) janë zbatuar plotësisht, tetëmbëdhjetë (18) veprime (apo 41.9%) janë zbatuar pjesërisht, dhe shtatë (7) veprime (apo 16.3%) nuk janë zbatuar.

Planifikimi dhe koordinimi i politikave – është shënuar progres në forcimin e kapaciteteve për planifikim dhe menaxhim strategjik përmes trajnimeve të realizuara, si dhe në rishikimin e ndërmjetëm të SKZH-së dhe rishikimin vjetor të PKIE-së, duke avancuar harmonizimin e tyre me dokumentet kryesore të planifikimit strategjik dhe prioritetet e zhvillimit. Po ashtu, është avancuar harmonizimi i Agjendës së Reformave me PKZH-në, PKIE-në dhe planet institucionale, duke siguruar integrimin e masave të reformave në kuadër të Instrumentit të BE-së për Reforma dhe Rritje Ekonomike për Ballkanin Perëndimor.

Në kuadër të rritjes së performancës institucionale, janë hartuar dhe miratuar planet institucionale të ministrive dhe ZKM-së dhe janë përcaktuar mekanizmat për monitorimin dhe raportimin e tyre. Gjithashtu, është avancuar zhvillimi i platformës mbarëqeveritare për planifikim dhe monitorim, ndërsa drafti i PKZH-së 2026–2028 është përgatitur dhe pritet të miratohet pas miratimit të Programit të Qeverisë. Progres është shënuar edhe në forcimin e transparencës, konsultimit publik dhe bashkëpunimit me shoqërinë civile, përmes zbatimit të strategjisë përkatëse, hartimit të Manualit të ri për Konsultimet Publike dhe avancimit të platformës elektronike. Në funksion të zhvillimit të politikave të bazuara në të dhëna dhe forcimit të kuadrit juridik, janë ndërmarrë hapa për ngritjen e kapaciteteve në hartimin e Koncept Dokumenteve, vlerësimin rregullator dhe konsolidimin e legjislacionit. Megjithatë, mbetet për t'u iniciuar procesi i ndryshimit të rregullores përkatëse.

Avancimi i shërbimeve të orientuara nga administrata publike – "Identifikimi i akteve nënligjore për harmonizimin me LPPA" mbetet në statusin "në vazhdimësi", pa ndryshime të reja gjatë periudhës raportuese. Në kuadër të ngritjes së kapaciteteve, në muajin mars është organizuar trajnimi "Transformimi i Shërbimeve Publike: Nga Sportelet Tradicionale në One Stop Shop dhe Shërbimet Digjitale", me pjesëmarrjen e 20 përfaqësuesve nga komunat, ndërsa planifikohet zhvillimi i trajnimeve edhe për dy grupe të tjera gjatë pjesës së dytë të vitit.

Aktivitetet për rritjen e cilësisë së shërbimeve janë në proces të zbatimit në kuadër të projektit të Bankës Botërore për Forcimin e Qeverisjes Digjitale për Ofrimin e Shërbimeve. Në kuadër të rritjes së qasjes dhe efikasitetit të shërbimeve, ASHI ka vazhduar publikimin e informacionit për shërbimet e institucioneve qendrore dhe lokale në platformën eKosova, si dhe mirëmbajtjen e kanaleve të komunikimit dhe mbështetjes për qytetarët. Gjatë periudhës së parë të vitit 2026 janë zhvilluar dhe publikuar dhjetë (10) shërbime të reja, ndërsa është ripublikuar edhe një shërbim periodik. Gjithashtu, platforma eKosova vazhdon të ofrojë qasje të barabartë në shërbimet elektronike edhe për personat me aftësi të kufizuara.

Shërbim publik profesional dhe menaxhim i burimeve njerëzore – Gjatë periudhës raportuese, ka vazhduar mbështetja teknike për menaxherët e personelit përmes SIMBNj-së dhe informimi i tyre për funksionalitetet e reja të sistemit. Është hartuar drafti fillestar i raportit vjetor për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, ndërsa të dhënat e mbetura janë në proces të përpunimit. Në procesin e ristrukturimit dhe sistematizimit të vendeve të punës është arritur progres prej 55% në ministri, përfshirë ZKM-në, dhe 22% në agjenci, me gjithsej 31 institucione. Për vitin 2026 është planifikuar rishikimi i Vlerësimit të Nevojave për Trajnim,

ndërsa janë hartuar edhe dokumentet për vlerësimin e cilësisë së trajnimeve. Gjatë periudhës raportuese janë realizuar 2 trajnime për nëpunësit civilë menaxherialë, me gjithsej 68 pjesëmarrës, duke kontribuar në forcimin e kapaciteteve në menaxhimin e burimeve njerëzore, zgjidhjen e problemeve dhe vendimmarrjen menaxheriale.


Rritja e nivelit të llogaridhënies dhe transparencës në administratën publike – Gjatë periudhës raportuese është shënuar progres në rritjen e llogaridhënies dhe transparencës në administratën publike, veçanërisht në procesin e racionalizimit të agjencive, menaxhimit të performancës, transparencës proaktive dhe monitorimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit. Në kuadër të racionalizimit janë përzgjedhur dhe dakorduar gjashtë (6) ministri të reja, ku është themeluar Grupi Punues për koordinimin e procesit, i cili ka zhvilluar dy takime dhe konsultime me ministritë përkatëse, janë përfunduar analizat strukturore dhe funksionale, ndërkaq Qeveria ka miratuar Projektligjin për racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënëse të agjencive nga Programi për Racionalizimin e Agjencive i vitit 2024.

Sa i përket menaxhimit të performancës, nga 54 agjenci për vitin 2026, 35 (64%) kanë miratuar Planet Vjetore të Performancës, 12 (22%) kanë dorëzuar draft-plane, ndërsa 7 (12%) nuk kanë raportuar për hartimin e tyre. Për vitin 2025, nga 53 agjenci, 29 (54%) kanë pasur plane të miratuara, ndërsa deri më 24 gusht 2026 janë pranuar 20 raporte vjetore të performancës për vitin 2025, prej të cilave 13 janë në përputhje me kërkesat ligjore.

Në fushën e inspektimit është miratuar Rregullorja për trajnimin, testimin dhe certifikimin e inspektorëve, janë përfunduar modulet e trajnimit dhe pritet që trajnimi i trajnerëve të fillojë në gusht, ndërsa trajnimi i inspektorëve në tremujorin e fundit të vitit 2026. Në kuadër të transparencës, AIP ka realizuar 5 aktivitete profesionale me 220 pjesëmarrës dhe ka përfunduar konsultimet me institucionet pilot për publikimin proaktiv të informatave. Ndërkohë, Zyra për Qeverisje të Mirë ka vazhduar monitorimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit; gjatë periudhës janar-qershor 2026 janë adresuar 5 raporte me 33 rekomandime. Në përgjithësi, është shënuar progres në forcimin e transparencës dhe llogaridhënies, por mbeten sfida në zbatimin e plotë të sistemit të menaxhimit të performancës, racionalizimin e agjencive dhe respektimin e afateve ligjore për raportim dhe zbatimin e rekomandimeve.

3. Progresi i përgjithshëm

Plani i Veprimit 2025–2027 për gjashtë (6) mujorin e parë të vitit 2026 përfshin gjithsej dyzet e tre (43) veprime, pa përfshirë veprimet me afat zbatimi "në vazhdimësi", disa prej të cilave kanë shënuar progres edhe gjatë këtij gjashtëmujori. Sipas të dhënave të mbledhura nga institucionet udhëheqëse dhe mbështetëse për zbatimin e veprimeve gjatë TM1–TM2, tetëmbëdhjetë (18) veprime, apo 41.9%, janë zbatuar plotësisht, tetëmbëdhjetë (18) veprime, apo 41.9%, janë zbatuar pjesërisht, ndërsa shtatë (7) veprim, apo 16.3%, nuk janë zbatuar.
Grafi 1: veprimet e zbatuara plotësisht, pjesërisht dhe të pazbatuara




Nëse statusin e realizimit të veprimeve për TM1-TM2 e ndajmë sipas katër objektivave strategjike, në përgjithësi objektiva e parë strategjike (planifikimi dhe koordinimi politikave i orientuar drejt rezultateve) ka shënuar progres të mirë, objektiva e dytë (avancimi i shërbimeve të orientuara nga administrata publike) ka shënuar progres, objektiva e tretë (shërbim publik profesional dhe menaxhim efektiv i burimeve njerëzore) po ashtu ka pasur progres të mirë, dhe objektiva e katërt (rritja e nivelit të llogaridhënies dhe transparencës në administratën publike) ka pasur progres të mirë.

Tabela 1: klasifikimi i veprimeve sipas objektivave strategjike dhe realizueshmëria TM1-TM2 2026

Objektiva strategjike	**Plotësisht të zbatuara**	**Pjesërisht të zbatuara**	**Pazbatuara**	**Gjithsej**
Planifikimi dhe koordinimi i politikave i orientuar drejt rezultateve	8 (53.3%)	7 (46.7%)	0	15
Avancimi i shërbimeve të orientuara nga administrata publike	7 (58.3%)	0	5 (41.7%)	12
Shërbim publik profesional dhe menaxhim efektiv i burimeve njerëzore	2 (25%)	4 (50%)	2 (25%)	8
Rritja e nivelit të llogaridhënies dhe transparencës në administratën publike	1 (12.5%)	7 (87.5%)	0	8
Total	**18 (41.9%)**	**18 (41.9%)**	**7 (16.3%)**	**43**

Pjesa në vazhdim ofron përshkrim më të hollësishëm sa i përket zbatimit të aktiviteteve sipas katër objektivave strategjike.

Objektivi i parë strategjik - ***Planifikimi dhe koordinimi i politikave i orientuar drejt rezultateve*** – përfshinë gjithsej 15 aktivitete, nga të cilat 8 veprime (apo 53.3%) janë zbatuar plotësisht dhe 7 veprime (apo 46.7%) janë zbatuar pjesërisht.



Është shënuar progres në forcimin e kapaciteteve për planifikim dhe menaxhim strategjik, koordinimin e politikave qeveritare dhe harmonizimin e dokumenteve strategjike. Në këtë drejtim, janë realizuar 5 trajnime të dedikuara për planifikim dhe menaxhim strategjik, me gjithsej 126 pjesëmarrës, duke përfshirë temat për zbatimin e politikave publike për përmbushjen e detyrimeve nga MSA, sistemin e menaxhimit të performancës në ministri, mbikëqyrjen e agjencive, zbatimin e Planit Kombëtar për Zhvillim 2030 dhe hartimin e dokumenteve strategjike. Po ashtu, janë identifikuar nevojat për ndryshimin e rregullores përkatëse, megjithëse ende nuk janë ndërmarrë hapat për inicimin dhe procedimin e ndryshimeve.

Në kuadër të forcimit të planifikimit strategjik, Zyra për Planifikim Strategjik ka përfunduar fazën e parë të rishikimit të ndërmjetëm të SKZH-së, është finalizuar raporti përkatës dhe ka filluar procesi i adresimit të gjetjeve të vlerësimit. Rishikimi pritet të përmbyllet me reflektimin e ndryshimeve në dokumentin e SKZH-së deri në tremujorin e tretë. Ndërkohë, zyrat përgjegjëse për Integrim Evropian kanë realizuar rishikimin e rregullt vjetor të PKIE-së, i cili, në bashkëpunim me ZPS, SKQ dhe ZL, është harmonizuar me draftin e PKZH-së 2026–2028.

Gjithashtu, është avancuar ndërlidhja e Agjendës së Reformave me dokumentet kryesore të planifikimit. Agjenda e Reformave përmban gjithsej 111 hapa reformash, prej të cilëve 95 hapa janë nën përgjegjësinë e institucioneve të Qeverisë. Nga këta 95 hapa, 52 ose 54.74% janë të përfshirë në PKZH 2025–2027, ndërsa 43 ose 45.26% nuk janë pjesë e tij. Gjatë rishikimit të PKIE-së, PKZH-së dhe planeve institucionale, ZKPSA dhe zyrat për Integrim Evropian në kuadër të ZKM-së kanë siguruar që masat e reformave të Agjendës së Reformave, në kuadër të Instrumentit të BE-së për Reforma dhe Rritje Ekonomike për Ballkanin Perëndimor, të reflektohen në këto dokumente.

Në kuadër të rritjes së performancës institucionale, transparencës dhe llogaridhënies, në bashkëpunim me ZPS-në janë zhvilluar takime koordinuese me ministritë e linjës dhe ZKM-në, si rezultat i të cilave janë hartuar dhe miratuar nga sekretarët e përgjithshëm planet institucionale të ministrive dhe të ZKM-së. Po ashtu, janë dhënë instruksionet për monitorimin dhe raportimin e zbatimit të këtyre planeve në baza tremujore nga sekretarët e përgjithshëm. Në këtë drejtim, është duke u zhvilluar edhe platforma mbarëqeveritare, përfshirë modulin për planifikim dhe monitorim. Kompania fituese për zhvillimin e platformës është shpallur në maj, ndërsa vendosja e saj në funksion pritet të përfundojë deri në qershor 2027.

Sa i përket Planit Kombëtar për Zhvillim 2026–2028, drafti është hartuar në bashkëpunim me ministritë e linjës, duke përfshirë harmonizimin e prioriteteve sektoriale, objektivave strategjike, masave dhe aktiviteteve për periudhën përkatëse. Megjithatë, miratimi i dokumentit nga Qeveria ende nuk është bërë, për shkak se Programi i Qeverisë, i cili shërben si bazë për përcaktimin dhe harmonizimin e prioriteteve qeveritare, ende nuk është miratuar. Pas miratimit, SKQ do të vazhdojë monitorimin e zbatimit të PKZH-së përmes mbledhjes periodike të të dhënave dhe përgatitjes së raporteve tremujore dhe vjetore. Raportet do të përmbajnë vlerësimin e progresit, rezultatet e arritura dhe rekomandimet për përmirësimin e zbatimit, ndërsa, me kërkesë të Kabinetit të Qeverisë, raportet e monitorimit do të përdoren për nevoja të brendshme institucionale dhe vendimmarrëse.

Në fushën e monitorimit të dokumenteve strategjike, Zyra për Planifikim Strategjik ka koordinuar procesin e hartimit të raporteve për strategjitë sektoriale dhe raportet përkatëse janë publikuar në ueb-faqet e institucioneve përgjegjëse. Ndërkohë, është shënuar progres në forcimin e transparencës, konsultimit publik dhe bashkëpunimit me shoqërinë civile përmes fillimit të zbatimit të projektit të financuar nga Bashkimi Evropian "Support for the Implementation of the Government of Kosovo's Strategy for Civil Society 2026–2031". Projekti synon forcimin e kapaciteteve institucionale për konsultime publike dhe bashkëpunim me shoqërinë civile, avancimin e pjesëmarrjes qytetare, përmirësimin e transparencës dhe llogaridhënies, si dhe harmonizimin e praktikave me standardet evropiane.


Në këtë kuadër, ka filluar hartimi dhe finalizimi i Manualit të ri për Konsultimet Publike**,** si dhe procesi i dizajnimit dhe specifikimit të platformës së re elektronike për konsultime publike, e cila synon të zëvendësojë platformën ekzistuese dhe të ofrojë funksionalitete më të avancuara. Gjithashtu, është duke u hartuar programi i trajnimeve për koordinatorët e konsultimeve publike në nivel qendror dhe lokal. Trajnimet pritet të zhvillohen pas finalizimit të manualit dhe platformës së re. Në këtë proces, IKAP pritet të ketë rol mbështetës, ndërsa ZQM/ZKM, në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile dhe partnerët, ka organizuar trajnime dhe aktivitete për ngritjen e kapaciteteve në fushën e konsultimit publik, përdorimit të platformave elektronike, financimit publik të OJQ-ve dhe parandalimit e luftimit të gjuhës së urrejtjes. Po ashtu, është hartuar Strategjia Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2026–2031, në përputhje me kuadrin përkatës ligjor dhe procedural.

Në kuadër të zhvillimit të politikave të bazuara në të dhëna dhe ngritjes së kapaciteteve, gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2026 IKAP ka identifikuar trajnerët dhe ka filluar përgatitjet për organizimin e trajnimeve për vlerësimin rregullator dhe hartimin e Koncept Dokumenteve, të cilat pritet të fillojnë në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2026. Trajnimet për hartimin e Koncept Dokumenteve janë përfshirë në planin vjetor të IKAP-it dhe do të realizohen në bashkëpunim me SKQ-në. Ato do të organizohen në 6 grupe, me nga 20–25 pjesëmarrës për grup, dhe do të fokusohen në metodologjinë e hartimit të Koncept Dokumenteve, identifikimin e problemeve, përcaktimin e objektivave, analizimin e opsioneve, vlerësimin e ndikimeve dhe mbledhjen e të dhënave.

Në fushën e konsolidimit të akteve juridike, janë realizuar 3 trajnime me gjithsej 65 pjesëmarrës, përfshirë trajnimin për "Vlerësimin Ex Post", me 13 pjesëmarrës, "Hartimi i Legjislacionit & LDS", me 20 pjesëmarrës, dhe "Hartimi i ligjeve dhe akteve nënligjore", me 32 pjesëmarrës.

Në kuadër të aktiviteteve për konsolidimin e ligjeve, gjatë vitit 2025, me përkrahjen e Misionit të OSBE-së, janë organizuar trajnime me zyrtarët ligjorë të ministrive, duke kontribuar në forcimin e kapaciteteve profesionale për përmirësimin dhe harmonizimin e legjislacionit.

Objektivi i dytë strategjik - ***Avancimi i shërbimeve të orientuara nga administrata publike*** – përfshinë gjithsej 12 aktivitete, nga të cilat 7 veprime (apo 58.3%) janë zbatuar plotësisht dhe 5 veprime (apo 41.7%) nuk janë zbatuar.



Gjatë periudhës raportuese, zbatimi i aktiviteteve në kuadër të objektivave për përmirësimin, digjitalizimin dhe rritjen e efikasitetit të shërbimeve publike ka vazhduar, me disa aktivitete që mbeten në proces dhe të tjera që janë realizuar sipas planifikimit. Në kuadër të harmonizimit të akteve nënligjore me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative (LPPA), aktiviteti mbetet në statusin "në vazhdimësi", pa ndryshime të reja gjatë periudhës raportuese. Në muajin mars është realizuar trajnimi "Transformimi i Shërbimeve Publike: Nga Sportelet Tradicionale në One Stop Shop dhe Shërbimet Digjitale", me pjesëmarrjen e 20 përfaqësuesve nga komunat. Sipas planit, trajnimi do të zhvillohet edhe me dy grupe të tjera gjatë pjesës së dytë të vitit. Aktivitetet janë duke u zbatuar përmes projektit të Bankës Botërore "Strengthening Digital Governance for Service Delivery Project (SDGSDP)", i cili synon forcimin e qeverisjes digjitale dhe përmirësimin e ofrimit të shërbimeve publike. ASHI ka vazhduar publikimin dhe mirëmbajtjen e listës së shërbimeve të institucioneve të nivelit qendror dhe lokal në platformën eKosova. Lista përmban informacione të detajuara për shërbimet, përfshirë institucionin ofrues, përshkrimin e shërbimit, bazën ligjore, dokumentacionin e nevojshëm, kostot, afatet kohore dhe mënyrën e paraqitjes së ankesave.

Gjatë pjesës së parë të vitit 2026, në platformën eKosova janë zhvilluar dhe publikuar 10 shërbime të reja, si vijon:


1. Vërtetimi për veturat në pronësi;
2. KRU Bifurkacioni – Shiko dhe paguaj faturat e ujit;
3. Aplikim për pëlqim ujor;
4. Aplikim për vazhdim të lejes ujore;
5. Aplikim për bartje të lejes ujore;
6. Aplikim për ndryshim të lejes ujore;
7. Pjesëmarrja e publikut në procedurat e akteve ujore;
8. Aplikim për leje ujore;
9. Aplikim për kushte ujore;

10. Regjistrohu si përfitues në Sistemin Informativ të Menaxhimit Financiar të Kosovës (SIMFK).

Përveç këtyre, gjatë periudhës raportuese është ripublikuar një shërbim periodik, përkatësisht Programi i Zhvillimit Rajonal të Balancuar (PZHRB) 2026 – Loti 1, i cili aktivizohet vetëm gjatë periudhës së hapur për aplikim.

Gjithashtu, kanë vazhduar të jenë funksionale kanalet e komunikimit dhe mbështetjes në eKosova, përfshirë komunikimin përmes e-mailit, njoftimet SMS, seksionin FAQ, video-udhëzuesit dhe modulin "Ndihma". Qytetarët vazhdojnë të kenë qasje edhe përmes aplikacioneve mobile të eKosova-s për Android dhe iOS, duke mundësuar përdorim më të lehtë dhe më të shpejtë të shërbimeve digjitale. Promovimi i performancës së administratës publike është realizuar përmes informimit të vazhdueshëm të qytetarëve mbi shërbimet dhe funksionalitetet e reja të eKosova-s, kryesisht përmes rrjeteve sociale dhe kanaleve të tjera të komunikimit. Këto aktivitete kontribuojnë në rritjen e transparencës, përdorimit të shërbimeve elektronike dhe orientimit të administratës publike drejt nevojave të qytetarëve. Në përgjithësi, periudha raportuese shënon vazhdim të reformave në digjitalizimin e shërbimeve publike, me theks të veçantë në zgjerimin e katalogut të shërbimeve në eKosova, ku gjatë pjesës së parë të vitit 2026 janë shtuar 10 shërbime të reja, ruajtjen e kanaleve të komunikimit me qytetarët, përmirësimin e qasjes në shërbime dhe avancimin e ofrimit të shërbimeve publike të orientuara drejt qytetarit.

Objektivi i tretë strategjik- ***Shërbim publik profesional dhe menaxhim efektiv i burimeve njerëzore*** – përfshinë gjithsej 8 aktivitete, nga të cilat 2 veprime (apo 25%) janë zbatuar plotësisht, 4 veprime (apo 50%) janë zbatuar pjesërisht dhe 2 veprime (apo 25%) nuk janë zbatuar.



Gjatë periudhës raportuese, janë ndërmarrë një sërë aktivitetesh në kuadër të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe zhvillimit të kapaciteteve të nëpunësve civilë. Ekipi për administrimin e Sistemit Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (SIMBNj) ka vazhduar të ofrojë mbështetje dhe këshillim teknik për menaxherët e personelit në institucionet përkatëse, përmes komunikimit telefonik, e-mailit dhe mbështetjes me prezencë fizike. Gjithashtu, përmes

Forumit të Menaxherëve të Burimeve Njerëzore, institucionet janë informuar rregullisht për ndryshimet, përmirësimet dhe funksionalitetet e reja të sistemit SIMBNj.

Është hartuar drafti fillestar i raportit vjetor për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore. Aktualisht është duke u bërë plotësimi dhe përpunimi i të dhënave të pranuara nga Thesari, ndërsa finalizimi i raportit pritet të bëhet brenda disa javësh. Sa i përket ristrukturimit dhe sistematizimit të vendeve të punës, procesi ka shënuar progres në ministritë, përfshirë Zyrën e Kryeministrit, me rreth 55%, ndërsa në agjenci është realizuar rreth 22%, me gjithsej 31 institucione të përfshira në proces.

Procesi i Vlerësimit të Nevojave për Trajnim (VNT) ka përfunduar në vitin 2025, ndërsa për vitin 2026 është planifikuar rishikimi i tij gjatë pjesës së dytë të vitit. Po ashtu, janë hartuar Procedura Standarde e Operimit dhe Udhëzimi për vlerësimin e cilësisë së trajnimit, Niveli 1 dhe 2. Në fushën e zhvillimit profesional, gjatë periudhës raportuese janë realizuar 2 trajnime për nëpunësit civilë menaxherialë, me gjithsej 68 pjesëmarrës. Trajnimi "Menaxhimi i burimeve njerëzore në sektorin publik" është ndjekur nga 16 pjesëmarrës, ndërsa trajnimi "Zgjidhja e problemeve dhe vendimmarrja menaxheriale" nga 52 pjesëmarrës. Në përgjithësi, periudha raportuese karakterizohet nga vazhdimi i mbështetjes teknike për institucionet përmes SIMBNj-së, avancimi i proceseve të raportimit dhe sistematizimit të vendeve të punës, përmirësimi i mekanizmave për vlerësimin e trajnimeve dhe forcimi i kapaciteteve menaxheriale përmes zhvillimit profesional.

Objektivi i katërt strategjik - ***Rritja e nivelit të llogaridhënies dhe transparencës në administratën publike*** – përfshinë gjithsej 8 aktivitete, nga të cilat 1 veprim (apo 12.5%) është zbatuar plotësisht dhe 7 veprime (apo 87.5%) janë zbatuar pjesërisht.



Gjatë periudhës raportuese është shënuar progres në rritjen e nivelit të llogaridhënies dhe transparencës në administratën publike, me fokus në racionalizimin e agjencive, zbatimin e Sistemit të Menaxhimit të Performancës, forcimin e kapaciteteve të inspektorëve, transparencën proaktive dhe monitorimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit. Në kuadër të procesit të racionalizimit të agjencive, janë përzgjedhur dhe dakorduar gjashtë ministri të reja për shqyrtim, përkatësisht Ministria e Financave, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, dhe Ministria për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare. Për sektorët e përzgjedhur janë përfunduar analizat strukturore dhe funksionale, të cilat kanë marrë në konsideratë aspektet financiare, obligimet që rrjedhin nga

MSA dhe dokumentet strategjike në vend, acquis të BE-së dhe praktikat e vendeve anëtare të BE-së. Për koordinimin e procesit, MDAP ka themeluar Grupin Punues me Vendimin nr. 1416/2026, datë 11 qershor 2026, i cili ka mbajtur dy takime si me GP ashtu edhe me përfaqësues të ministrive, dhe ka koordinuar aktivitetet dhe hapat e mëtejmë të procesit. Më 8-9 shtator 2026, është planifikar mbajtja e punëtorisë mbi shqyrtimin dhe analizimin e opsioneve për racionalizim për secilën agjenci/ trup brenda këtyre sektorëve, dhe sipas planifikimeve, brenda afateve dhe procedurave ligjore, programi i ri për 6 sektorët do të miratohet në qeveri në tetor 2026.

Në drejtim të kompletimit të kuadrit ligjor, Qeveria ka miratuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me Racionalizimin dhe Vendosjen e Vijave Llogaridhënëse të Agjencive, me Vendimin nr. 05/11, datë 20 prill 2026, i cili është proceduar për shqyrtim dhe miratim në Kuvend. Më tej në drejtim të monitorimit të planifikimeve të kuadrit ligjor që është në zbatim të Programit të miratuar në vitin 2024 për sektorët e ME dhe MKRS, sipas planifikimeve nga Ministria e Ekonomisë pritet finalizimi Koncept Dokumentin për KPMM në dhjetor 2026; Projektligji për Komunikimet Elektronike, ka dal në konsultime paraprake dhe publike, pritet të finalizohet në dhjetor 2026; Finalizimi i projektligjit për ZRRE, në shtator 2026. Po ashtu, ME- ka proceduar në Kuvend projektligjin për Energjinë Elektrike që ka të bëjë me KOSTT (konsiderohet e kryer sa i përket qeverisë). Tre hapat e parë me obligime nga si më lartë, janë vendosur në afatet e fundit sipas planifikimeve, dhe për secilin ka nën hapa si: themelimi i GP; mbajtja e takimeve; finalizimi i dokumentit; konsultimet etj.

Sipas planifikimeve nga Ministria e Kulturës, Projektligji për Inspektoratin është miratuar në 2024, dhe MKRS, e ka proceduar në Kuvend; Finalizimi i projektligjit për muzetë pritet të përfundoj/ miratohet në dhjetor 2026.

Sa i përket Sistemit të Menaxhimit të Performancës për vitin 2026, numri i agjencive që i nënshtrohen këtij procesi është 53. Nga këto, 38 agjenci ose 71% kanë miratuar Planet Vjetore të Performancës, prej të cilave 30 brenda afatit ligjor dhe 8 jashtë afatit ligjor.

Planet e miratuara brenda afatit ligjor – 30 agjenci:

1. Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës;
2. Inspektorati Policor i Kosovës;
3. Agjencia e Regjistrimit Civil;
4. Agjencia e Menaxhimit të Emergjencave;
5. Akademia e Kosovës për Siguri Publike;
6. Agjencia e Kosovës për Forenzikë;
7. Agjencia e Shoqërisë së Informacionit;
8. Instituti i Kosovës për Administratë Publike;
9. Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë;
10. Agjencia e Pyjeve të Kosovës;
11. Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë;
12. Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale;
13. Zyra e Inspektorit të Përgjithshëm;
14. Agjencia për Barazi Gjinore;
15. Avokatura Shtetërore;
16. Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar;
17. Instituti i Mjekësisë Ligjore;
18. Shërbimi Korrektues i Kosovës;

19. Inspektorati i Ministrisë së Drejtësisë;
20. Agjencia për Menaxhimin e Monumenteve dhe Kompleksеve Memoriale;
21. Agjencia Anti-Doping;
22. Agjencia Shtetërore e Arkivave;
23. Agjencia për Zhvillimin e Rinisë;
24. Shërbimi Gjeologjik i Kosovës;
25. Agjencia e Metrologjisë së Kosovës;
26. Agjencia për Pronësi Industriale;
27. Drejtoria e Akreditimit të Kosovës;
28. Shërbimi Sprovues i Kosovës;
29. Inspektorati Qendror për Mbikëqyrje të Tregut;
30. Agjencia për Ndihmë Juridike Falas.

Planet e miratuara jashtë afatit ligjor – 8 agjenci:

1. Agjencia e Punësimit;
2. Administrata Tatimore e Kosovës;
3. Dogana e Kosovës;
4. Thesari i Kosovës;
5. Njësia për Inteligjencë Financiare;
6. Agjencia Qendrore e Prokurimit;
7. Inspektorati Qendror i Punës;
8. Agjencia e Statistikave të Kosovës.

Draft-Planet e pranuara – 8 agjenci:

1. Agjencia Kadastrale e Kosovës;
2. Agjencia e Kosovës për Akreditim – MASHT;
3. Agjencia Kosovare e Standardizimit;
4. Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve;
5. Instituti i Krimeve të Kryera gjatë Luftës;
6. Agjencia e Sportit;
7. Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore;
8. Agjencia për Investime dhe Përkrahje të Ndërmarrjeve.

Agjencitë që nuk kanë ofruar informacione për hartimin e Planeve të Performancës – 7 agjenci:

1. Agjencia për Shërbimet e Navigacionit Ajror;
2. Policia e Kosovës;
3. Agjencia për Siguri Kibernetike;
4. Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional;
5. Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve;
6. Agjencia e Financimit Shëndetësor;
7. Inspektorati i Shëndetësisë.

Sa i përket gjendjes së Raporteve Vjetore mbi zbatimin e Planeve të Performancës për vitin 2025, nga 53 agjenci të identifikuara, 30 agjenci ose 56% kanë pasur Plan të Performancës të miratuar. Deri më 21 gusht 2026 janë pranuar gjithsej 23 raporte, prej të cilave 15 janë në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurale.

Raportet e pranuara në përputhje me kërkesat ligjore – 15 agjenci:

1. Inspektorati Qendror i Tregut;
2. Agjencia e Metrologjisë së Kosovës;
3. Agjencia Kosovare e Standardizimit;
4. Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës;
5. Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar;
6. Shërbimi Korrektues i Kosovës;
7. Inspektorati i Ministrisë së Drejtësisë;
8. Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale;
9. Agjencia për Ndihmë Juridike Falas;
10. Avokatura Shtetërore;
11. Inspektorati i Punës;
12. Instituti i Mjekësisë Ligjore;
13. Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës;
14. Agjencia për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale
15. Agjencia e Punësimit të Republikës së Kosovës.

Agjencitë që kanë pasur Plan të Performancës të miratuar për vitin 2025, por nuk kanë ofruar Raport Vjetor – 15 agjenci:

1. Dogana e Kosovës;
2. Policia e Kosovës;
3. Inspektorati Policor i Kosovës;
4. Agjencia për Shërbimet e Navigacionit Ajror;
5. Agjencia e Menaxhimit të Emergjencave;
6. Agjencia e Kosovës për Forenzikë;
7. Administrata Tatimore e Kosovës;
8. Thesari;
9. Shërbimi Sprovues i Kosovës;
10. Agjencia Pyjore e Kosovës;
11. Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë;
12. Agjencia e Regjistrimit Civil;
13. Agjencia e Shoqërisë së Informacionit;
14. Agjencia Qendrore e Prokurimit;
15. Agjencia për Pronësi Industriale.

Agjencitë që nuk kanë pasur Plan të Performancës të miratuar për vitin 2025, por kanë dorëzuar Raport Vjetor – 7 agjenci:

1. Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit;
2. Agjencia e Regjistrimit të Biznesit;
3. Agjencia për Investime dhe Mbështetje të Bizneseve;
4. Agjencia për Barazi Gjinore;
5. Agjencia e Statistikave të Kosovës;
6. Zyra e Inspektorit të Përgjithshëm;
7. Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë.

Në fushën e inspektimit, është miratuar Rregullorja për trajnimin, testimin dhe certifikimin e inspektorëve dhe janë krijuar modulet përkatëse të trajnimit. Faza e përzgjedhjes së

kandidatëve për trajnerë ka përfunduar, ndërsa trajnimi i trajnerëve fillon në gusht 2026. Pas certifikimit të trajnerëve pritet të fillojë trajnimi i inspektorëve, i cili është planifikuar për tremujorin e fundit të vitit 2026. Për vendosjen e sistemit online të testimit vazhdojnë komunikimet me organizatat partnere për sigurimin e financimit. Në kuadër të transparencës dhe qasjes në dokumente publike, Agjencia për Informim dhe Privatësi, me mbështetjen e EULEX-it, ka realizuar pesë aktivitete profesionale, përfshirë tryeza të rrumbullakëta dhe punëtori tematike, me gjithsej 220 pjesëmarrës nga institucionet qendrore, komunat, OJQ-të dhe mediat. Gjithashtu, AIP ka përfunduar konsultimet me institucionet partnere për zbatimin e publikimit proaktiv të dokumenteve publike. Në këtë proces janë përzgjedhur pesë institucione pilot, me qëllim krijimin e një modeli të unifikuar dhe të standardizuar të transparencës që mund të aplikohet edhe në institucionet e tjera publike.

Sa i përket monitorimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit, Zyra për Qeverisje të Mirë/ZKM ka vazhduar koordinimin ndërinstitucional dhe përditësimin e matricës së monitorimit. Situata e zbatimit të rekomandimeve diskutohet në takimet e rregullta të sekretarëve të përgjithshëm të ministrive, ndërsa institucionet rikujtohen për detyrimin që përgjigjet ndaj Avokatit të Popullit t'i kthejnë brenda afatit ligjor prej 30 ditësh. Gjatë periudhës janar-qershor 2026, nga Institucioni i Avokatit të Popullit janë adresuar 5 raporte me gjithsej 33 rekomandime. Megjithatë, mbetet sfidë fakti se disa institucione nuk e përfshijnë Zyrën për Qeverisje të Mirë në kopje gjatë komunikimit me Avokatin e Popullit, duke vështirësuar përditësimin e matricës dhe monitorimin e respektimit të afateve dhe zbatimit të rekomandimeve.

Në përgjithësi, gjatë periudhës raportuese është shënuar progres në forcimin e mekanizmave të llogaridhënies dhe transparencës, veçanërisht përmes avancimit të procesit të racionalizimit të agjencive, miratimit dhe monitorimit të Planeve të Performancës, forcimit të transparencës proaktive dhe zhvillimit të kapaciteteve të inspektorëve. Megjithatë, të dhënat tregojnë se mbeten sfida në sigurimin e zbatimit të plotë dhe në kohë të kërkesave ligjore, veçanërisht në lidhje me miratimin e planeve, dorëzimin e raporteve vjetore të performancës dhe zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit.

4. Problemet dhe rreziqet

Me gjithë progresin në zbatimin e aktiviteteve (plotësisht dhe pjesërisht) gjatë periudhës TM1-TM2 dhe atyre që kanë nisur pavarësisht se afatin e kanë "në vazhdimësi" siç është cekur në fillim, sfidat kryesore për vonesat në zbatimin e tyre lidhen me:

1. Harmonizimi i ligjeve të veçanta që përmbajnë procedura administrative me LPPA ka ngecur edhe për shkak të mungesës së vendosjes së një mekanizmi për të lehtësuar dialogun tematik ndërmjet Qeverisë - Ministrisë - Kuvendit për këtë çështje. Ky aktivitet parashihet në PV 2025-2027 të realizohet në bashkëpunim me Komisionin e Kuvendit për administratë publike mirëpo në mungesë të tij, aktiviteti nuk është realizuar. Për më tepër, faza e tretë e harmonizimit (84 ligje të identifikuara) nuk është kryer;
2. Organizimi i brendshëm i MDAP-së nuk është kompletuar me të cilin proces është planifikuar të adresohet edhe krijimi i njësisë përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve.

Mungesa e definimit të detyrave dhe përgjegjësive për këtë njësi, ka ndikuar në zbatimin e aktiviteteve për këtë periudhë raportuese, por edhe në vitin paraprapak;

3. Niveli i zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga Avokati i Popullit është i ulët, edhe pse ka progres krahasuar me vitin paraprak. Në IAP janë adresuar 5 raporte me gjithsej 33 rekomandime. Megjithatë, mbetet sfidë fakti se disa institucione nuk e përfshijnë Zyrën për Qeverisje të Mirë në kopje gjatë komunikimit me Avokatin e Popullit, duke vështirësuar përditësimin e matricës dhe monitorimin e respektimit të afateve dhe zbatimit të rekomandimeve;
4. Funksionimi i Qeverisë me mandat të kufizuar dhe mos konstituimi i Kuvendit pas zgjedhjeve të qershorit 2026, ka ndikuar në mos zbatimin e aktiviteteve të lidhura me miratimin në Qeveri dhe Kuvend;
5. Zbatim i ngadalshëm i procesit të racionalizimit të agjencive. Projektligji për racionalizimin e agjencive ekzekutive në sektorin e kulturës dhe ekonomisë i hartuar në 2024, është miratuar në Qeveri por për shkak të gjendjes me zgjedhjet parlamentare nuk ka shkuar në Kuvend. Po ashtu, ka vonesa në zbatimin e programit paraprak për racionalizimin e agjencive të miratuar në Qeveri ngase Ministritë nuk kanë mundur të procedojnë me draftim dhe miratim të ligjeve sektoriale të identifikuara në procesin e racionalizimit të agjencive rregullatore;
6. Zbatim i ngadalshëm i sistemit të menaxhimit të performancës së agjencive. Me gjithë kërkesën nga ministria përgjegjëse për administratë publike, disa agjenci nuk kanë raportuar nëse kanë hartuar plane të performancës për 2026 e disa prej tyre kanë hartuar draftet e para, mirëpo nuk janë miratuar. Ky proces është ndikuar nga mos themelimi i njësive përgjegjëse brenda ministrive me të cilat agjencitë dakordojnë planet e performancës para miratimit të tyre final nga drejtori i agjencisë;

Mos zbatimi në nivel të duhur i aktiviteteve sipas PV 2025-2027 ndikon në vonesat në zbatim të reformave në administratën publike sipas SRAP 2022-2027 dhe rrjedhimisht marrjen e vlerësimeve negative nga organizata të ndryshme përfshirë vlerësimin nga Raporti për vendin i Komisionit Evropian. Po ashtu, vonesat e tilla shkaktojnë edhe mos përmbushjen e obligimeve nga ana e Qeverisë sipas Planit të Rritjes të dakorduar në mes të Komisionit Evropian dhe Qeverisë dhe mos përfitimet e parapara financiare në këtë drejtim.

5. Hapat e ardhshëm

Sipas sfidave të adresuara më lartë, ky raport propozon marrjen e këtyre hapave me qëllim rritjen e nivelit të zbatimit të aktiviteteve gjatë periudhës TM3-TM4 2026. Kjo pjesë paraqitet në mënyrë tabelare për të bërë lidhjen në mes të problemit dhe zgjidhjes së propozuar.

Sfida	**Rekomandimi**

Zbatim i ngadalshëm i procesit të racionalizimit të agjencive	MDAP, të organizojë takime në nivel politik me institucionet në mënyrë që të parandalohet krijimi i agjencive/ trupave të ri në sistemin e administratës shtetërore, dhe të zbatohet Manuali për krijimin, bashkimin dhe shuarjen e agjencive;
	MDAP/DRAP të vazhdojë konsultimet me ME dhe MKRS sa i përket planifikimit dhe përgatitjes së pakos ligjore që mundësojnë zbatimin e Programit për Racionalizimin e Agjencive të miratuar në shtator 2024;
Zbatim i ngadalshëm i sistemit të menaxhimit të performancës për agjencitë në kuadër të administratës shtetërore	DRAP të komunikojë me agjencitë të cilat janë në grupin e atyre që nuk kanë hartuar plane të performancës, dhe grupin e agjencive që kanë dërguar vetëm draftet e para dhe të dizajnojë në koordinim me to mbështetjen e nevojshme nga DRAP në mënyrë që të ketë rezultate më të mira në zbatimin e sistemit të menaxhimit të performancës për agjencitë, sipas LOFASHAP;
	DRAP sipas nevojës të kërkojë mbështetje me ekspertizë nga partnerë zhvillimorë në fushën e reformave në administratën publike;
Niveli i ulët i zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga Avokati i Popullit, dhe mos komunikimi ndërinstitucional	Institucioni i Avokatit të Popullit dhe Zyra për Qeverisje të Mirë të organizojnë fushatë ndërgjegjësimi për zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit. Të intensifikohet komunikimi dhe presioni ndaj institucioneve që u janë adresuar rekomandimet, që të njëjtat të zbatohen pa shkaktuar vonesa;
Mungesa e progresit me harmonizimin e ligjeve që përmbajnë procedura të veçanta administrative me LPPA	Departamenti ligjor (DL) i MDAP të fillojë me identifikimin e grupit të tretë (faza III) të ligjeve për harmonizim me LPPA. Sipas nevojës, DL të konsultohet me partnerët zhvillimorë për mbështetje me ekspertizë në këtë proces;
Mos definimi i strukturës përgjegjëse në MDAP për ofrimin e shërbimeve	MDAP të përfundojë organizimin e brendshëm me rregullore, të parasheh krijimin e njësisë përgjegjëse në fushën e ofrimit të shërbimeve dhe të definojë detyrat e saj;
Planifikimi i monitorimit të institucioneve për zbatimin e rregullave sipas LZP për shërbimin civil	Pas konstituimit të plotë të Kuvendit dhe formimit të Qeverisë, të nisë procedura e kompletimit të KPMSHC për miratim në Kuvend në mënyrë që të kompletohet funksionalizimi i KPMSHC;

SHTOJCA 5 – AKTIVITETET PASUESE NGA PLANI I VEPRIMIT 2025-2027, PËR VITIN 2026

Nr.	Aktiviteti	Institucioni përgjegjës dhe mbështetës	Koha	Statusi	Shënim
	OBJEKTIVI I PERGJITHSHEM 1: PLANIFIKIMI DHE KOORDINIMI I POLITIKAVE I ORIENTUAR DREJT REZULTATEVE				
Masat	**Objektiva specifik 1.1 Sistem efektiv dhe i integruar i planifikimit të politikave**				
1.1.2	Rishikimi i Rregullores së Punës së Qeverisë në bazë të gjetjeve të vlerësimit	ZKM	TM2 2026	Pjesërisht e zbatuar	Janë identifikuar nevojat për ndryshimin e kësaj rregulloreje. Megjithatë, deri më tani nuk janë ndërmarrë hapat e mëtejmë për inicimin dhe procedimin e ndryshimeve përkatëse.
1.1.7	Mbajtja e trajnimeve për shërbyesit civil në nivel qendror – për planifikim dhe menaxhim strategjik	IKAP	Në vazhdimësi	Zbatuar	Janë realizuar këto trajnime të dedikuara për planifikim dhe menaxhim strategjik: "Zbatimi i politikave publike për përmbushjen e detyrimeve nga MSA" kanë marr pjesë 40 pjesëmarrës; Trajnimi "Sistemi i Menaxhimit të Performancës në Ministri" kanë marr pjesë 40 pjesëmarrës; Trajnimi "Sistemi i Menaxhimit të Performancës dhe mbikëqyrja e Agjencive" 22 pjesëmarrës; Trajnimi " Zbatimi i Planit Kombëtar për Zhvillim 2030" 15 pjesëmarrës; Trajnimi "Hartimi i dokumenteve strategjike" 9 pjesëmarrës. Në total: 5 trajnime, 126 pjesëmarrës.
1.1.9	Rishikimi i ndërmjetëm i Strategjisë Kombëtare për Zhvillim, vlerësimi i zbatimit dhe rishikimi i treguesve të ndikimit	ZPS/ZKM Ministritë e linjës	TM2 2026	Zbatuar	ZPS, ka përfunduar fazën e parë të rishikimit të ndërmjetëm, është finalizuar raporti dhe jemi në proces të adresimit të gjetjeve të vlerësimit. Rishikimi i ndërmjetëm finalizohet më reflektimin e ndryshimeve në dokumentin e SKZH-së, që pritet të bëhet deri në tremujorin e tretë.
1.1.10	Reflektimi i masave afatshkurtra të Programit Kombëtar për	ZKM	Në vazhdimësi	Zbatuar	Zyrat përgjegjëse për Integrim Evropian kanë bërë rishikimin e rregullt vjetor të PKIE-së. Gjatë këtij procesi, në bashkëpunim

	Integrim Evropian (PKIE) si aktivitete të PKZH për vitin 2025 gjatë rishikimit vjetor të të dy dokumenteve	Ministritë dhe institucionet e tjera relevante			me ZPS, SKQ dhe ZL ky program është harmonizuar me draftin e PKZH 2026–2028.
1.1.11	Reflektimi i masave/hapave reformave të Agjendës së Reformave në kuadër të Instrumentit të BE-së për Reforma dhe Rritje Ekonomike për Ballkanin Perëndimor (AR) në pjesët relevante të PKZH-së (për vitet 2025-2027) gjatë rishikimit vjetor të PKZH-së	ZKM Ministritë dhe institucionet e tjera relevante	Në vazhdimësi	Zbatuar	Agjenda e Reformave përmban gjithsej 111 hapa të reformave, prej të cilëve 95 janë nën përgjegjësiinë e institucioneve të Qeverisë. Prej këtyre 95 hapave të reformave, 52 (54.74%) janë pjesë e PKZH 2025-2027, ndërsa 43 (45.26%) prej tyre nuk janë pjesë e tij.
	Objektivi specifik 2: Rritja e performancës institucionale, transparencës dhe llogaridhënies				
1.2.2	Aplikimi i planeve institucionale në të gjitha nivelet ministrore	ZKM Ministritë e linjës	TM1 2026	Zbatuar	Në bashkëpunim me ZPS-në, janë zhvilluar takime koordinuese me ministritë e linjës dhe ZKM-në. Si rezultat, janë hartuar planet institucionale në ministritë, përfshirë edhe ZKM-në.
1.2.3	Zhvillimi i instruksioneve dhe formave te monitorimit dhe raportimit te Planeve Institucionale	ZKM, Ministritë e Linjës	Q1 2026	Zbatuar	Janë dhënë instruksionet për monitorimin dhe raportimin e zbatimit të Planeve Institucionale. Monitorimi dhe raportimi do të realizohen çdo tre muaj nga sekretarët e përgjithshëm të ministrive të linjës.
1.2.4	Zhvillimi i sistemit elektronik për planifikim, monitorim dhe raportim të punës së Qeverisë	ZKM Ministritë e linjës	TM2 2026	Pjesërisht e zbatuar	Ky aktivitet ndërlidhet me zbatimin e platformës mbarëqeveritare. Në maj të këtij viti është shallur kompania fituese për zhvillimin e kësaj platforme, ku përfshihet edhe moduli për Planifikim dhe monitorim. Tërë procesi i vendosjes së platformës në funksion pritet të finalizohet dëri ne qershor 2027.
1.2.5	Organizimi strukturor në ZKM dhe Ministri për sistemin elektronik për planifikim, monitorim dhe raportim	ZKM	TM1 2026	Pjesërisht e zbatuar	Ndërlidhet me aktivitetin më lartë.

1.2.7	Përgatitja dhe publikimi i raporteve periodike dhe vjetore të punës së Qeverisë (PKZH)	ZSP-ZKM	TM1 TM4 2025 Në vazhdimësi	Pjesërisht e zbatuar	Drafti i Planit Kombëtar për Zhvillim për periudhën 2026–2028 është hartuar në fund të vitit të kaluar, në bashkëpunim me ministritë e linjës. Gjatë procesit të hartimit janë mbledhur dhe harmonizuar prioritetet sektoriale, objektivat strategjike, masat dhe aktivitetet e planifikuara për periudhën përkatëse. Megjithatë, dokumenti ende nuk është miratuar nga Qeveria, për shkak se Programi i Qeverisë, i cili shërben si bazë për përcaktimin dhe harmonizimin e prioriteteve qeveritare, ende nuk është miratuar.
1.2.8	Zhvillimi i raporteve për strategjitë sektoriale dhe publikimi i tyre	ZKM Ministritë e linjës	Në vazhdimësi	Zbatuar	ZPS, e ka koordinuar procesin e hartimti të raporteve për strategjitë sektoriale, dhe të njëjtat janë publikuar në ueb faqet e institucioneve përgjegjëse.
1.2.11	Ngritja e kapaciteteve/trajnim i i nëpunësve civilë/pikat fokale për zbatimin e manualit në nivel qendror)	ZKM/ZQM	TM2 2026	Pjesërisht e zbatuar	Një nga zhvillimet kryesore gjatë periudhës raportuese ishte fillimi i zbatimit të projektit të financuar nga Bashkimi Evropian "Support for the Implementation of the Government of Kosovo's Strategy for Civil Society 2026–2031", nga Zyra për Qeverisje të Mirë në Zyrën e Kryeministrit.
1.2.13	Trajnim për përdorimin e platformës nga institucionet	IKAP ZKM/ZQM	TM2 2026	Pjesërisht e zbatuar	Aktiviteti është planifikuar për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2026. Fjala është për platformën për konsultime publike, e cila pritet të avancohet dhe të shoqërohet me hartimin e manualit për konsultime publike. IKAP është në pritje të ZKM/ZQM për dërgimin e manualit dhe hartimin e materialit të trajnimit, pas së cilës do të organizohen trajnimet për përdorimin e platformës nga institucionet. Në këtë rast IKAP duhet te jete institucion mbështetës.
I.3.	**Objektivi Specifik 3.: Zhvillimi i politikave duke u bazuar në të dhëna dhe ngritja e kapaciteteve**				

1.3.5	Mbajtja e trajnimeve për shërbyes civil për vlerësim rregullatorë/konc ept dokumente	SKQ/ZKM IKAP	Në vazhdimësi	Pjesërisht e zbatuar	Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2026, IKAP ka identifikuar trajnerët për këtë aktivitet dhe ka filluar përgatitjet organizative. Trajnimet për vlerësim rregullator dhe koncept dokumente do të fillojnë në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2026.
1.3.14	Trajnimi zyrtarëve përkatës për konsolidimin e akteve juridike	ZPGZ/ZKM IKAP	TM1 2026 Në vazhdimësi	Zbatuar	Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2026, me përkrahjen e Misionit të OSBE-së, janë organizuar trajnime për konsolidimin e akteve juridike, të dedikuara për zyrtarët ligjorë të ministrive dhe zyrtarët ligjorë të komunave. Në kuadër të këtyre trajnimeve janë përfshirë gjithsej 76 pjesëmarrës**,** prej të cilëve 40 zyrtarë ligjorë nga ministritë dhe 36 zyrtarë ligjorë nga komunat**.** Trajnimet kanë pasur për qëllim avancimin e njohurive dhe kapaciteteve profesionale të zyrtarëve përkatës në fushën e konsolidimit të akteve juridike.
	OBJEKTIVI I PËRGJITHSHË 2: AVANCIMI I SHËEBIMEVE TË ORIENTUARA NGA ADMINISTRATA PUBLIKE				
	Objektivi Specifik 1: Harmonizimi dhe riorganizimi i ofrimit të shërbimeve				
2.1.3	Identifikimi i akteve nënligjore për harmonizimin me LPPA.	DL/DRAP/MDAP/Ministritë e linjës	Në vazhdimësi	Pa zbatuar	Identifikimi i akteve nënligjore për harmonizimin me LPPA" mbetet në statusin "në vazhdimësi", pra nuk ka ndryshime.
2.1.6	Trajnimi i personelit të zyrave pritëse për marrëdhëniet me klientët në nivel qendror dhe lokal	MDAP/IKAP	Në vazhdimësi	Zbatuar	Ne muajin mars është mbajtur trajnimi "Transformimi i Shërbimeve Publike: Nga Sportelet Tradicionale në One Stop Shop dhe Shërbimet Digjitale", me grupin e parë te pjesëmarrësve nga komunat. Ne trajnim kanë marr pjesë 20 pjesëmarrës. Sipas planit te trajnimit, ne pjesën e dytë të vitit trajnimi do te mbahet edhe me dy grupe tjera.
2.1.7	Aktivitete të komunikimit dhe ndërgjegjësimit për të mbështetur zbatimin e LPPA (ndërlidhet me themelimin e njësisë për ofrimin e shërbimeve- përgjegjësi e saj	MDAP	Në vazhdimësi	Pa Zbatuar	Nuk eshte raportuar

2.1.8	Vendosja e një mekanizmi për të lehtësuar dialogun tematik ndërmjet Qeverisë - Ministrisë - Parlamentit lidhur me domosdoshmërinë e procesit të harmonizimit të ligjeve të veçanta me LPPA (ndërlidhet me themelimin e njësisë për ofrimin e shërbimeve- përgjegjësi e saj)	MDAP/ZKM/ Komisioni Parlamentar për AP	TM1 2025 dhe në vazhdimësi	Pa zbatuar	Nuk eshte raportuar
	Objektivi Specifik 2: Fuqizimi i udhëheqjes dhe koordinimit institucional qendror				
2.2.3	Ngritja e grupeve tematike me pjesëmarrës të zyrtarëve publikë, OSHC-ve, bizneseve për të diskutuar problemet dhe sfidat në përmirësimin e shërbimeve (vendim për themelimin e njësisë)	DRAP/MDAP	Në vazhdimësi	Pa Zbatuar	Nuk eshte raportuar
2.2.4	Konferenca vjetore me temën e ofrimit të shërbimeve (vendim për themelimin e njësisë)	DRAP/MDAP	Në vazhdimësi	Pa Zbatuar	Nuk eshte raportuar
	Objektivi Specifik 3: Rritja e cilësisë në ofrimin e shërbimeve				
2.3.1	Inventari i shërbimeve është përditësuar dhe përmirësuar me shërbime të reja dhe elemente shtesë.	ASHI	TM4 2027 në vrazhdësi	Zbatuar	Ky aktivitet është në proces të zbatimit në kuadër të projektit të Bankës Botërore "Strengthening Digital Governance for Service Delivery Project (SDGSDP)" / Projekti i Forcimit të Qeverisjes Digjitale për Ofrimin e Shërbimeve.
	Objektivi Specifik 4: Rritja e qasjes dhe efikasitetit të ofrimit të shërbimeve				
2.4.6	Publikimi i listës së shërbimeve, përshkrimit, mënyrës së ofrimit, të dhënave të ofruesit, dokumenteve dhe kostos, afateve dhe mënyrës së ankesës në faqet e internetit të institucioneve publike që ofrojnë shërbime.	ASHI/MAPL	Në vazhdimësi	Zbatuar	ASHI, në përputhje me përgjegjësitë dhe rolin e saj, ka publikuar në kuadër të platformës eKosova listën e shërbimeve që ofrohen nga institucionet e nivelit qendror e lokal. Linku për qasje në këtë listë është: https://ekosova.rks-gov.net/Informations Kjo listë përmban informacion të detajuar për secilin shërbim, duke përfshirë: institucionin ofrues, përshkrimin e shërbimit,

					bazën ligjore, mënyrën e ofrimit, të dhënat e ofruesit, dokumentacionin e nevojshëm, kostot, afatet kohore, mënyrën e paraqitjes së ankesave etj.. Sic e kemi potencuar edhe më parë, ASHI nuk ka përgjegjësi dhe as qasje për të publikuar informacione në ueb faqet e institucioneve të tjera. Gjithsesi, duhet theksuar se disa komuna kanë publikuar listën e shërbimeve që ofrojnë.
2.4.7	Instalimi i kanaleve të reja të komunikimit (e-mail, sms, video dhe audio incizime, pyetje të shpeshta) për të lehtësuar qasjen në shërbimeve	MDAP/ASHI	Në vazhdimësi	Zbatuar	Gjatë periudhës raportuese nuk ka pasur zhvillime të reja lidhur me këtë aktivitet. Nga ana tjetër, mbeten funksionale kanalet e komunikimit dhe mbështetjes të implementuara në kuadër të platformës eKosova, të cilat përfshijnë komunikimin përmes postës elektronike (e-mail), njoftimet përmes SMS-së, seksionin e pyetjeve të shpeshta (FAQ), video-udhëzuesit për përdorimin e shërbimeve, si dhe modulin Ndihma, i cili ofron informata dhe udhëzime për përdorimin e shërbimeve elektronike.
2.4.8	Promovimi i performancës së administratës në shërbime të orientuara për qytetarët	MDAP/ASHI	Në vazhdimësi	Zbatuar	Promovimi i performancës së administratës publike realizohet nga ASHI nëpërmjet informimit të vazhdueshëm të qytetarëve për shërbimet dhe funksionalitetet e reja të platformës eKosova. Informimi zhvillohet kryesisht nëpërmjet rrjeteve sociale dhe kanaleve të tjera të komunikimit, duke promovuar shërbimet e digjitalizuara, përmirësimet e realizuara dhe funksionalitetet e reja të orientuara drejt nevojave të qytetarëve. Këto aktivitete kontribuojnë në rritjen e transparencës, përdorimit të shërbimeve elektronike dhe qasjes së administratës publike të orientuar ndaj qytetarit.
2.4.9	Zgjerimi me shërbime të reja të portalit e-Kosova si dritarja e vetme elektronike për	MDAP/ASHI	Në vazhdimësi	Zbatuar	Gjatë periudhës së parë të vitit 2026, në platformën eKosova janë zhvilluar dhe publikuar dhjetë (10) shërbime të reja.

	ofrimin e shërbimeve administrative publike.				Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe është ripublikuar në platformën eKosova një (1) shërbim që ka karakter periodik. Këto shërbime publikohen vetëm gjatë periudhës kur thirrjet janë të hapura për aplikim dhe çaktivizohen pas përfundimit të afatit të aplikimit. Shërbimi i ripublikuara është: 1. Programi i zhvillimit rajonal të balancuar (PZHRB) 2026 - Loti 1.
2.4.10	Të gjitha shërbimet elektronike do të jenë të disponueshëm për personat me aftësi të kufizuara (alfabeti braille, përkthyesi i zërit, etj.)	MDAP/ASHI	T4 2025 në vazhdimësi	Zbatuar	Platforma eKosova mundëson qasje të barabartë, navigim dhe marrje të shërbimeve në mënyrë elektronike edhe për personat me aftësi ndryshe/personat me aftësi të kufizuara, bazuar në standardet ndërkombëtare.
	OBJEKTIVI I PËRGJITHSHËN 3: SHËRBIM PUBLIK DHE MENAXHIM I BBURIMEVE NJERËZORE				
	Objektivi specifik 1: Korniza ligjore dhe institucionale për shërbimin civil është përmirësuar				
3.1.7	Ofrimi i trajnimeve për NJMBJ për përdorimin e SIMBNJ, futjen, përditësimin dhe menaxhimin e të dhënave të personelit me qëllim të përmirësimit dhe sigurimit të të dhënave të sakta dhe cilësore	MDAP/DMZP/IKAP	Në vazhdimësi	Pjesërisht e zbatuar	Ekipi i administrimit të SIMBNj-së ka ofruar mbështetje dhe këshillim teknik të vazhdueshëm për menaxherët e personelit në institucionet përkatëse përmes: komunikimit telefonik; përmes e-mailit; dhe ofrimit të mbështetjes me prezencë fizike. Gjithashtu, në kuadër të Forumit të Menaxherëve të Burimeve Njerëzore, janë prezantuar në mënyrë të rregullt ndryshimet, përmirësimet dhe avancimet e realizuara në sistemin SIMBNj, me qëllim informimin e institucioneve dhe lehtësimin e zbatimit të funksionaliteteve të reja.
	Objektivi Specifik 2: Shërbimi publik aplikon parimet e profesionalizmit, meritokracisë, efikasitetit dhe mundësive të barabarta				
3.2.9	Ofrimi i programeve të trajnimit për ngritjen e kapaciteteve analitike të NJMBNJ-ve në mbështetje të arritjes së qëllimeve operacionale dhe strategjike nëpërmjet planit të personelit	MDAP/DMZP-IKAP	Në vazhdimësi	Pa Zbatuar	Nuk eshte raportuar
3.2.10	Zhvillimi i kapaciteteve të stafit menaxherial për zbatimin e rekrutimit,	MDAP/DMZP-IKAP	Në vazhdimësi	Pa Zbatuar	Nuk eshte raportuar

	vlerësimit të rezultateve të punës dhe përfundimit të marrëdhënieve të punës në shërbim publik				
3.2.15	Hartimi dhe miratimi i raportit vjetor për menaxhimin e burimeve njerëzore	DMZP/MDAP	TM4 2025 dhe ne vazhdimësi	Pjesërisht e zbatuar	Është hartuar drafti fillestar i raportit vjetor për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore. Aktualisht janë në përpunim të dhënat që kanë munguar dhe që janë pranuar nga Thesari. Drafti përfundimtar pritet të finalizohet brenda disa javësh.
	Objektivi Specifik 3: Sistem i drejtë, transparent dhe i barabartë për pagat është krijuar dhe zbatohet në praktikë				
3.3.2	Ristrukturimi dhe sistematizimi i vendeve të punës të ministrive	MDAP/DMZP/IRK	TM2 2026	Pjesërisht e zbatuar	Ministritë (përfshirë ZKM-në) 55% Agjencitë –22% **- Totali: 31**
	Objektivi Specifik 4: Sistemit i zhvillimit profesional të nëpunësve civilë është përmirësuar dhe funksionon				
3.4.2	Vlerësimi i nevojave për trajnim	IKAP/MDAP	Në vazhdimësi	Zbatuar	Ka perfunduar procesi i VNT ne vitin 2025, per kete vit eshte ne plan rishikimi i VNT , ne pjesen e dyte te vitit.
3.4.6	Përditësimi i metodologjisë për vlerësimin e ndikimit të programeve të trajnimit	MDAP/IKAP	TM1 2026	Pjesërisht e zbatuar	Eshte hartuar Procedura standarde e operimit dhe Udhezimi per vleresimin e cilesisie se trajnimit , Niveli 1 dhe 2.
3.4.8	Trajnimi i nëpunësve civil të nivelit menaxherial për planifikimin e objektivave vjetore të nëpunësve civilë dhe harmonizimi i tyre me objektiva të institucionit	MDAP/IKAP	Në vazhdimësi	Zbatuar	Janë realizuar këto trajnime për nëpunësit civil menaxherial: Trajnimi "Menaxhimi i burimeve njerëzore në sektorin publik" 16 pjesëmarrës; Trajnimi "Zgjidhja e problemeve dhe vendimmarrja menaxherial" 52 pjesëmarrës Në total: 2 trajnime, 68 pjesëmarrës.
	OBJEKTIVI I PËRGJITHSHËM 4: RRITJA E NIVELIT TË LLOGARIDHËNIES DHE TRANSPARENCËS NË ADMINISTRATËN PUBLIKE				
	Objektivi Specifik 1: Përmirësimi i organizimit të administratës shtetërore me vija të qarta të llogaridhënies brenda dhe në mes të institucioneve				
4.1.4	Hartimi dhe miratimi i Programit për Racionalizimin e Agjencive për sektorët e ri të mbetur	DRAP/MDAP	TM2 2025-TM4 2027	Pjesërisht e zbatuar	Në kuadër të procesit të racionalizimit të agjencive, janë përzgjedhur dhe dakorduar 6 ministri për shqyrtim. (MF), (MMPH), (MIT), (MD), (MASHTI), dhe (MPFVLÇ). Për përzgjedhjen e këtyre ministrive janë zhvilluar konsultime ndërinstitucionale dhe takime në nivel politik me ministritë përkatëse, përmes të

					cilave është siguruar dakordimi për përfshirjen e tyre në procesin e racionalizimit.
4.1.6	Hartimi dhe miratimi i legjislacionit te nevojshëm bazuar në Programin e ri te miratuar për Racionalizimin e Agjencive për sektorët e ri te mbetur (ne ndërlidhje me aktivitetin 4.1.4)	DRAP/MPB	TM4 2027	Pjesërisht e zbatuar	Qeveria ka miratuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me Racionalizimin dhe Vendosjen e Vijave Llogaridhënëse të Agjencive Ekzekutive**,** me Vendimin nr. 05/11, datë 20 prill 2026, i cili është proceduar për shqyrtim dhe miratim në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Ligjet per sektoret e ri, do te miratohen pas miratimit te programit te ri.
	Monitorimi dhe përcjellja e zbatimit të legjislacionit për racionalizim te agjencive në vazhdimësi	DRAP/ MDAP	TM4 2027	Pjesërisht e zbatuar	Për zbatimin dhe koordinimin e aktiviteteve të parapara në kuadër të këtij procesi, me Vendim të Sekretares së Ministrisë së Digjitalizimit dhe Administratës Publike nr. 1416/2026, datë 11 qershor 2026, është themeluar Grupi Punues, me mandat për koordinimin dhe avancimin e procesit të racionalizimit të agjencive, si dhe monitorimin e vazhdueshem te legjislacionit pasues.

4.1.8	Zbatimi i sistemit të menaxhimit të performancës së agjencive	Ministritë Agjencitë/	Në vazhdimësi	Pjesërisht e zbatuar	Planet Vjetore të Performancës së Agjencive dhe Raportet Vjetore mbi zbatimin e Planeve të Performancës janë obligim që rrjedhin nga Ligji Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, Rregullorja Nr. 12/2023 mbi Zbatimin e Sistemit të Menaxhimit të Performancës për Agjencitë në kuadër të Administratës Shtetërore, si dhe Udhëzuesi për Sistemin e Menaxhimit të Performancës për Agjencitë. Deri më 21 gusht 2026 kemi pranuar gjithsej njëzetetri (23) raporte. Prej tyre vetëm pesëmbëdhjetë (15) apo 50 % janë në përputhje me kërkesat e ligjore, nga gjithsej tridhjetë (30) agjenci për të cilat kemi pranuar Planin e Performancës të miratuar për vitin 2025. Pesëmbëdhjetë (15) agjenci apo 50 % nuk kanë ofruar raport mbi zbatimin e planit të performances, ndërsa shtatë (7) raporte te tjera janë dorëzuar nga agjenci që nuk kanë pasur Plan të Performancës të miratuar për vitin 2025.
4.1.16	Trajnimi i detyrueshëm, testimi dhe certifikimi i inspektoreve	ZKM/Zyra për Inspektime/IKAP	Në vazhdimësi	Pjesërisht e zbatuar	Ka përfunduar faza e përzgjedhjes se kandidateve për trajner, ne fund te korrikut do te filloj trajnimi i tyre dhe pas certifikimit te tyre pritet te filloj trajnimi i inspektoreve, ndersa per sistemin online te testimit ,jemi ne komunikim me disa organizata partnere, per ta financuar vendosjen e ketij sistemi.
	Objektivi Specifik 2: Rritja e qasjes në dokumente publike nga qytetarët dhe bizneset në nivel qendror dhe lokal				
4.2.6	Organizim i konferencës vjetore iniciuar nga AIP, në bashkëpunim me Kuvendin, Qeverinë, komunat, shoqërinë civile dhe media lidhur me realizimin e së	AIP Qeveria, Kuvendi, Komunat, OJQ-të, mediat	TM4 2025, në vazhdimësi	Zbatuar	Me mbështetje të vazhdueshme të Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX) nga Agjencia për Informim dhe Privatësi (AIP), janë organizuar dhe realizuar pesë aktivitete profesionale, të përbëra nga tryeza të

	drejtës për qasje në dokumente publike				rrumbullakëta dhe punëtori tematike. Me një përfshirje të ***220 pjesëmarrës*** nga institucione qendrore të vendit, zyrtarë për qasje në dokumente publike nga niveli komunal, OJQ dhe media, ku janë organizuar katër punëtori me temë: *''Balancimi i së Drejtës për Qasje në Dokumente Publike dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale".*
	Objektivi Specifik 3: Rritja e nivelit të zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura nga institucionet në nivel qendror dhe lokal				
4.3.1	Përgatitja e planeve të Informimit, konsultimit dhe koordinimit me institucionet të cilave ju adresohet rekomandimi	Avokati i Popullit Zyra e Qeverisjes së Mirë / ZKM	Në vazhdim ësi	Pjesërisht e zbatuar	Zyra e Kryeministrit/Zyra për Qeverisje të Mirë është e obliguar në baze të Ligjit nr.05\L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në mënyrë të veçantë neni 10 pika 1.2 të monitoron në mënyrë të vazhdueshme zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit. ZQM/ZKM, ka mbet e angazhuar në forcimin dhe fuqizimin e koordinimit ndërinstitucional me institucionet të cilave ju adresohet rekomadimi.
4.3.2	Përditësimi dhe mirëmbajtja e matricës së monitorimit për zbatimin e rekomandimeve të avokatit të popullit	ZQM/ZKM Ministritë	Në vazhdim ësi	Pjesërisht e zbatuar	Përditësimi dhe mirëmbajtja e matricës së monitorimit për zbatimin e rekomandimeve të avokatit të popullit është proces që bëhet në vazhdimësi dhe rregullisht nga ZQM. Gjatë periudhës janar-qershor 2026 nga Institucioni i Avokatit të Popullit janë adresuar: 5 Raporte me 33 rekomandime.